



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:280421

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06070856

A.nr. 2954/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, në konfliktin administrativ të paditësit F.SH., fshati ..., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, me bazë juridike, anulim të vendimit, me prezencë të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, pas shqyrtimit kryesor publik, të mbajtur, me datë 02.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit ..., fshati ..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi A .nr.153/2021, i datës 03.11.2021, duke obliguar të paditurën Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, që të miratoj ankesën e paditësit dhe të obligon Komunën e Shtimes që të lejoj kthimin në gjendje të mëparshme të objektit të djegur me sipërfaqe 147 m², në ngastrën kadastrale 01665-1.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me datën 14.12.2021, në gjykatë ka parashtruar padi kundër të Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, për shkak të anulimit të vendimit A-153/21 i datës 03.11.2021. Më tej në padi ka theksuar se Komuna e Shtimes me datën 09.08.2021 Drejtoria për Planifikim dhe Urban dhe Kadastër ka nxjerr Aktvendim duke refuzuar kërkesën dhe paralajmëruar palën se nuk i epet pëlqimi për kthimin e objektit në gjendjen e mëparshme. Paditësi ka ushtruar ankesë për herë të tretë tek e paditura duke bashkangjitur tërë dokumentacionin përcjellës që nga data 17.12.2017, në kohën kur është kapluar zjarri i tërë lokali. E paditura me datën 27.10.2021 ka kërkuar nga inspektorati i kësaj ministrie që të dal në vend ngjarje për të konstatuar gjendjen reale dhe faktike dhe konstatimi është bërë "në lokacion nuk ka objekt, lokacioni është pastruar në tërësi dhe nuk figuron objekt , me qenë se nga Komuna e Shtimes është dhënë pëlqimi nr.08/01/45, të datës 04.05.2018 për pastrimin e mbeturinave nga objekti i djegur. E paditura bazuar në këtë fare nuk ka marr për bazë se kushtet për dhënien e pëlqimit për pastrimin e objektit mund të jepet ndërsa për kthim në gjendjen e mëparshme nuk ka kushte.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësit deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë dhe njëherit kërkoj që e njëjta të miratohet si e bazuar. Gjatë bisedimit me

drejtoreshën nuk kemi arritur marrëveshje dhe mbi bazën e kësaj kërkoj që të merren pretendimet e mia në padi kundër vendimit kontestues të datës 03.11.2021 me të cilën është refuzuar ankesa. E paditura MMPHI në përgjigjen në padi dhe në parashtrësën e dërguar për deklarim thotë se neni 25 i ligjit 04L/110 për ndërtim është i pazbatueshëm pasi që kanë ndryshuar rrethanat dhe janë bërë ndryshime rrënjësore por pa arsyetuar dhe konstatuar se nga kush janë ndryshuar rrethanat: nga vis majoris apo dora e njeriut. Edhe pse kjo ministri e pranon se është dhënë pëlqimi për pastrim të mbeturinave në tërësi pasi që paraqet rrezik për banorët. Në pëlqimin e datës 04.05.2018 e dhënë nga drejtoria përkatëse në pikën 5 kërkon që pastrimi i mbeturinave, vendi ku pastrohet duhet të rrethohet ose përkufizohet e që nënkupton që patjetër duhet të pastrohen muret nga tullat e lloqit dhe gërmadhat nga djega prej zjarrit. Shfrytëzuesit e lokalit asnjëherë nuk kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e komunës, po do të donim që janë në kundërshtim me kërkesat ka qenë e pamundur pasi që gjatë rrënimit kanë asistuar policia dhe inspektorët e komunës të cilët e kanë bërë kontrollin deri në përfundim të punës. Dua të jem i qarte dhe konkret se padia nuk është ushtruar që të merret leja për ndërtimin e një objekti shumë katesh apo thellimin e podrumit 1 apo 2 kate duke ndryshuar në tërësi gjendjen lokale të mëparshme, kërkesa jonë ka qenë kthim në gjendjen e mëparshme konform dispozitave ligjore në fuqi neni 25 të ligjit për ndërtim 04/110 i cili thotë “në rast të dëmtimit të objekteve ndërtimore nga forca madhore sipas ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, riparimi dhe rindërtimi i atyre objekteve mund të bëhet pa leje ndërtimore.” Bazuar në këtë dhe padisë së ushtruar si dhe provat e bashkangjitura kërkoj nga kjo gjykatë që këtë padi ta miratoj si të bazuar dhe ta obligoj MMPH duke pranuar ankesën time si të bazuar dhe e njëjta ti propozoj Komunës së Shtimës-Drejtorisë përkatëse që të lejoj kthimin e gjendjes së mëparshme të lokalit të djegur. Dhe gjykatës ja dorëzoj si provë certifikatën e pronësisë e datës 26.03.2024 ku lokali evidentohet si shfrytëzim aktual shtëpi-ndërtesë dhe fleta poseduese e viteve të mëhershme si dhe provat tjera relevante. Ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi i propozoj gjykata që në bazë të provave të administruara të marr aktgjykim duke e aprovuar padinë në tërësi si të bazuar duke e anuluar vendimin e të paditurës A-154/21 të datës 03.11.2021 dhe duke obliguar të paditurën MMHPI që ta miratoj ankesën e paditësit si të bazuar dhe të obligon Komunën e Shtimes- Drejtorinë përkatëse që të lejoj kthimin në gjendje të mëparshme të objektit të djegur me sipërfaqe 147 m² në ngastrën kadastrale ...

E paditura përmes avokaturës shtetërore me përgjigjen në padi të datës 08.12.2023 dh enë parashtrësën e datës 01.07.2024 ka theksuar se e paditura bazuar në procedurën e shqyrtimit të të gjitha shkresave dhe të gjitha konstatimet e bëra, konstaton se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme për ndërtimin e objektit i cili është shkatërruar krejtësisht nga zjarri dhe nuk ekziston në parcelën kadastrale nr.1665-1, tani është e pamundur sepse rrënimi tani është realizuar në tërësi dhe objekti nuk ekziston i cili do ti plotësonte kushtet për riparim dhe ndërtim. Meqenëse rrethanat kanë ndryshuar në tersi dhe janë bërë ndryshime rrënjësore në rastin konkret nuk është i zbatueshëm neni 25 par.1 i Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim por vlen dispozitat e neni 14 të Ligjit për Ndërtim dhe dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi. Më tutje ka theksuar se bazuar në Planin Hapësinor ... datës 31.03.2011, ngastra kadastrale gjendet në zonën B, blloku B2 dhe specifikohet kriteri minimal për ndërtim e që duhet të jetë 400 m², ndërsa parcela në të cilën është parashtruar kërkesa ka sipërfaqe 147 m² që nuk plotëson kriterin sipas dokumentit të planifikimit hapësinor. Po ashtu gjendja faktike në teren është konstatuar nga Inspektorati MMPHI në shkresën numër 820-4/21 të datës 27.10.2021, që objekti nuk ekziston. Andaj duke u nisur nga konstatimet e lartëcekura i propozojmë gjykatës që të refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi numër A.nr.153/21 i datës 03.11.2021 .

Në seancën e shqyrtimit kryesor me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: : Vendim Nr.A-153/21, i dt. 03.11.2021 nga MMPHI, Ankesa e paditësit, e dt. 01.09.2021, Aktvendim i dt. 09.08.2021, nga Komuna e Shtimes – Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kërkesë e dt.05.07.2021, nga paditësi, Vendim i dt. 29.04.2021 me numër 34/21, MMPHI, Përgjigje në kërkesë e dt. 10.06.2021, nga Komuna e Shtimes- Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Tabela e llogaritjes së parametrave urban, Plani Rregullues Urban për Qytetin e Shtimes, Ankesa e paditësit e dt. 25.02.2021, Kërkesë nga paditësi e dt. 19.10.2020, drejtuar Komunës së Shtimes - Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kërkesë nga paditësi e dt. 16.07.2020, drejtuar Komunës së Shtimes - Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Përgjigje në kërkesë e dt. 30.11.2020, nga Komuna e Shtimes- Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Pëlqim për pastrimin e mbeturinave nga objekti i djegur i dt. 04.05.2018 me numër 08/01/45, nga Komuna e Shtimes- Drejtoria për Shërbime Publike, Përgjigje në kërkesën e paditësit për investim dt. 30.09.2020, Përgjigje në kërkesë-Vlerësim i dëmit nga Zjarri, dt. 21.12.2017, nga Komuna e Shtimes-Drejtoria për shërbime publike, Formulari për biznes – regjistrimi i dëmeve të shkaktuara gjatë fatkeqësisë në emër të ..., lloji i objektit Biznes në sipërfaqe prej $6 \times 9 = 54$ m², kati P+0, vendi i objektit Shtime, rruga "...", nr. 38,21.12.2017, Pamjet (fotot) nga vendi i ngjarjes së zjarrit të shkaktuar më dt. 18.12.2017, (tri kopje), Kontratë për Qiranë, dt. 10.10.2018, në emër të qiramarrësit ... dhe qiradhënësit ..., Vlerësimi me numër 08/02/87 i datës 21.12.2017, Certifikatë Njësia Kadastrale 01665-1 e datës 26.03.2024, Skica e planit të mëhershëm, Certifikatë Njësia Kadastrale e datës 20.10.2021, Fotografia – fotoja, gjendja ku ka qenë objekti, Vendim Nr.A-153/21, dt. 03.11.2021 nga MMPHI, Kërkesë e dt. 29.09.2021, nga MMPHI, Njoftim i dt. 25.10.2021, nga MMPHI, Njoftim nga MMPHI (nuk identifikohet datë), Vendim dt.09.07.2021,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit me padi si dhe propozimin e paditësit për anulimin e të njëjtit, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Nga Vendimi nr.06/53, të datës 09.08.202, gjykata vërtetoi se Komuna e Shtimes , Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, ka refuzuar ankesën për rishqyrtim të parashtruar për herë të fundit me nr.06/350/02/21071, të datës 30.11.2020 nga paditësi për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e objektit në parcelën 1665-1, sipër faqe 147 m²pronë PS Kooperativa Bujqësore e menaxhuar nga APK-ja.

Nga Aktvendimi i të paditurës numri nr. A.153/2021, të datës 11.03.2021, gjykata vërtetoi se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit kundër vendimit 06/53, të datës 09.08.2021 dhe ka vërtetuar vendimin e datës 09.08.2021, të Komunës së Shtimes, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.

Gjykata duke iu referuar dispozitave ligjore nenit 5 të ligjit për Ndërtim, llojet e ndërtimit përcaktohet se “ 1. Llojet e ndërtimit janë: 1.1. ndërtimi i ri (duke përfshirë instalimin); 1.2. rindërtimi; 1.3. riparimi – renovimi, sanimi, rehabilitimi-përmirësimi (nuk kërkon leje ndërtimi); 1.4. punët ndërtimore që kanë për synim mbrojtjen e monumenteve të palëvizshme të trashëgimisë kulturore; 1.5. rrënim; 1.6. ndërtime peizazhi, dhe 1.7. instalimi apo ngritja e ndërtimeve të përkohshme”. Ndërsa neni 14 i Ligjit për Ndërtim përcakton se “ Leja

ndërtimore kërkohet për aktivitetet vijuese: 1.1. ndërtimi i ri (përfshirë montazhet); 1.2. rindërtimi i objekteve ekzistuese; 1.3. rrënimi i objekteve ekzistuese, dhe 1.4. riparimi i objektit ndërtimor, nëse ndodh ndryshim thelbësor i tij krahasuar me situatën para paraqitjes së dëmit nga katastrofat natyrore, luftërat apo ngjarjet e ngjashme. 1.5. intervenimet në fasadat dhe strukturën (sanimet) e një objekti ekzistues.”

Me nenin 25 të Ligjit për Ndërtim përcaktohet se *“Dëmet e shkaktuara objekteve ndërtimore par.1. Në rast të dëmtimit të objekteve ndërtimore nga forca madhore sipas Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, riparimi dhe rindërtimi i atyre objekteve mund të bëhet pa leje ndërtimore nëse nuk bëhen ndryshime rrënjësore nga gjendja para dëmtimit, përveç objekteve të cilat kanë qenë të ndërtuara pa leje”. Par.2. Në rast se riparimet dhe rindërtimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni bëjnë ndryshime qenësore në objekt, leja ndërtimore për riparim dhe rindërtim do të merret brenda dy (2) viteve nga dita e paraqitjes së dëmit. Për qëllim të këtij paragrafi, “ndryshimet qenësore” i referohen kushteve ndërtimore. Nëse riparimet dhe rindërtimet bëhen në objekt të trashëgimisë kulturore, kërkohet leja ndërtimore dhe harmonizimi me legjislacionin për trashëgimi kulturore. Dhe par. 3. Riparimet dhe rindërtimet e bëra sipas këtij neni mund të bëhen në bazë të vendimit që nxjerr Qeveria sipas propozimit të Institucioneve përkatëse”.*

Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Andaj nga shkresat e lëndës paditësi edhe para Gjykatës nuk ka arritur të dëshmojë se kërkesa e tij i plotëson kushtet sipas kushteve të veçanta, se pari në kuptim të sipërfaqes së kërkuar 147 m², sepse nga përgjigja e të paditurës në bazë të Planit Rregullues Urban NPI-01/78, datës 31.03.2011, ngastra kadastrale 1665-1, me sipërfaqe 147 m², pronë e Kooperativës Bujqësore, gjendet në Zonën B, Blloku B2 dhe është e rregulluar që parcela minimale për ndërtim duhet të jetë 400 m² dhe në këtë rast gjykata vlerësoi se nuk plotësohen kriteret sipas sipërfaqes minimale të planit rregullues. Po ashtu nga provat e ofruara në shkresat e lëndës dhe të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor objekti i dëmtuar nga shkaqet e zjarrit për të cilin kërkohet rindërtimi dhe kthimi në gjendjen e mëparshme nuk ekziston kjo vërtetohet edhe nga shkresa e Inspektoratit të Komunës së Shtimes Nr.08/01/45, të datës 04.05.2018, objekt ky i cili do të plotësonte kushtet për rindërtim dhe në rastin konkret për shkak të gjendjes faktike dhe rrethanës së krijuar kërkesa e paditësit nuk gjenë mbështetje ligjore konform nenit 25 të Ligjit 04/L-110 për Ndërtim.

Gjykata këtu kishte parasysh se paditësi edhe me padi dhe as gjatë shqyrtimit gjyqësor Gjykatës nuk ka ofruar asnjë provë se i njëjti plotëson kushtet për rindërtim dhe kthim në gjendje të mëparshme të objektit që Gjykata të ketë një vendim ndryshe nga ky në dispozitiv të vendimit, dispozitat ligjore janë një detyrim për secilin dhe duhen respektuar në përpikëri, në këtë kuptim kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të ti.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor por të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pa bazuara, pasi që paditësi nuk ka argumentuar në mënyrë që gjykata të ketë një vendim ndryshe nga ai në diapozitivin e vendimit.

Prandaj Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thënie të paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u morën duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 2954/2021, datë: 02.07.2024

G j y q t a r j a
Valbona Gjonbalaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.